REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE**

# VENDIM

**Nr.** 699 **, datë** 22.10.2014

**PËR**

## PËRJASHTIMIN OSE REDUKTIMIN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT E STUDENTËVE QË NDJEKIN PROGRAMET E STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË TË CIKLIT TË PARË, PROGRAMET E STUDIMEVE JOUNIVERSITARE, PROFESIONALE, PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, SI DHE PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË "MASTER PROFESIONAL" DHE "MASTER I SHKENCAVE"/"MASTER I ARTEVE TË BUKURA" NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2014 - 2015

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993, "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar, të ligjit nr.10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", dhe të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit studentët, që ndjekin ciklin e parë të studimeve "Bachelor", programet e studimeve jouniversitare

profesionale dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", me formë studimi me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë dhe që vijnë nga këto shtresa sociale, si:

a) personat që nuk shikojnë/dëgjojnë;
b) invalidët e punës dhe fëmijët e tyre;
c) invalidët;
ç) invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe fëmijët e tyre;
d) jetimët;
dh) romët;
e) ballkano - egjiptianët;
ë) personi, njëri nga prindërit e të cilit është ndarë nga jeta, dhe familja, në këtë rast, përfiton ndihmë ekonomike nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore;
f) ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë nga sistemi komunist ose fëmijët me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;
g) fëmijët e policëve dhe të ushtarakëve të Forcave të Armatosura që kanë humbur jetën ose janë plagosur për shkak të detyrës;
gj) të prekurit nga HIV/AIDS.

2. Paguajnë 50% të tarifës vjetore të shkollimit studentët, që ndjekin ciklin e dytë të studimeve "Master Profesional" ose "Master i Shkencave"/ "Master i Arteve të Bukura", me formë studimi me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë dhe që vijnë nga shtresat sociale, si:

a) personat që nuk shikojnë/dëgjojnë;
b) invalidët e punës dhe fëmijët e tyre;
c) invalidët;
ç) invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe fëmijët e tyre;
d) jetimët;
dh) romët;
e) ballkano - egjiptianët;
ë) personi, njëri nga prindërit e të cilit është ndarë nga jeta, dhe familja, në këtë rast, përfiton ndihmë ekonomike nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore;
f) ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë nga sistemi komunist ose fëmijët me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;
g) fëmijët e policëve dhe të ushtarakëve të Forcave të Armatosura që kanë humbur jetën ose janë plagosur për shkak të detyrës;
gj) të prekurit nga HIV/AIDS.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

MINISTRI I ARSIMIT
DHE SPORTIT

LINDITA NIKOLLA

NR.PROT.3872/1
DATË 23.10.2014

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT
INSPEKTORATIT SHTETËROR TË ARSIMIT
UNIVERSITETIT PUBLIK TË TIRANËS
UNIVERSITETIT PUBLIK "ALEKSANDËR MOJSIU"
TË DURRËSIT
UNIVERSITETIT PUBLIK "ALEKSANDËR XHUVANI"
TË ELBASANIT
UNIVERSITETIT PUBLIK "LUIGJ GURAKUQI"
TË SHKODRËS
UNIVERSITETIT PUBLIK " FAN.S.NOLI"
TË KORÇËS
UNIVERSITETIT PUBLIK "EQEREM ÇABEJ"
TË GJIROKASTRËS
UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS
UNIVERSITETIT TË ARTEVE TË TIRANËS
UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË
UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS
UNIVERSITTIT TË SPORTEVE, TIRANË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretar i Përgjithshëm**

**Engjëll AGAÇI**